

## KONTRATE PER SHITJEN E KUOTAVE

Ne Tirane, sot, me 14.10.2019, palët e mëposhtme lidhin këtë kontrate shitblerje kuotash.

**Z. Erind Sula**, i biri i Tajar-it i datëlindjes 05.12.1992, lindur në Çorovode dhe banues në Tiranë, pajisur me nr.personal **E55626007Q**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, më poshtë i quajtur "**shitësi**",

dhe

**Z. Bledar Sula**, i biri i Tajar-it i datëlindjes 13.03.1977, lindur në Çorovode dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, pajisur me nr.personal **H70313071H**, më poshtë e quajtur "**blerësi**";

SHITESI DHE BLERESI bien dakord për sa vijon:

### SHITJAE KUOTAVE NENI I

Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësi sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontrate, kuotat që zotëron Shitësi në shoqërinë "LIFE TOURS" SHPK, një shoqëri e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar me Regjistrin Tregtar me numër biznesi L82016003M, dhe me seli të regjistruar në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa Nr. 173, Hyrja 23, Apartamenti 3, Kodi Postar 1001, Shqipëri (me poshtë e quajtur "Shoqëria"), që përfaqësojnë 60% të kapitalit të Shoqërisë, kundrejt çmimit të përcaktuar në nenin 2 të kësaj Kontrate.

### ÇMIMI I SHITJES DHE MENYRA E PAGESES NENI 2

2.1 Blerësi do të paguaje Shitësit për blerjen e kuotave të përcaktuara në nenin 1 të kësaj Kontrate, çmimin e përgjithshëm 60,000 Leke (me poshtë "çmimi i Shitjes").

2.2 Blerësi do të kryejë pagesën e çmimit të Shitjes, në favor të Shitësit, nëpërmjet transferimit të shumës përkatëse në llogarinë bankare të Shitësit, në fonde menjëherë të përdorshme, brenda ditës së nënshkrimit të kësaj kontrate.

### TRANSFERIMI I PRONESISE MBI KUOTAT NENI 3

3.1 Me ndryshimin e statutit të Shoqërisë, kapitali i Shoqërisë do të konsistojë në 2 kuota, ku kuotat e blera nga Blerësi do të konsistojnë në 1 kuota, me vlerë 60,000 Leke, që përfaqëson 60% të kapitalit të Shoqërisë ("Kuota e Blerësit").

3.2 Pronësia mbi Kuotën e Blerësit do të kalojë nga Shitësi të Blerësi me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

3.3 Me kalimin e pronësisë mbi Kuotën e Blerësit, Blerësi behet pronar i 1 kuote me vlere 60,000 Leke, qe përfaqëson 60% te kapitalit te Shoqërisë dhe Shitësi mbetet pronar i 1 kuote me vlere 40,000 Leke, qe përfaqëson 40% te kapitalit te Shoqërisë.

#### **DEKLARIMET DHE GARANCITE E PALEVE NENI 4**

4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin Se: (I) Shitësi është pronar i ligjshëm dhe i vetëm i Kuotës se Blerësit; (ii) Kuota e Blerësit është e lire nga pengu dhe/ose barra siguroese ne favor te te tretëve; (iii) Shitësi gëzon te gjitha te drejtat dhe ka te gjitha autorizimet e nevojshëm qe te realizoje transaksionin e përshkruar ne këtë Kontrate, duke përmbushur te gjithë detyrimet e marra përsipër ne këtë Kontrate; (iv) kjo Kontrate përben detyrim ligjor, te vlefshëm, te detyrueshëm dhe te ekzekutueshëm ndaj Shitësit.

4.2 Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin Se: (i) Blerësi nuk ka asnjë pengim Ligjor qe te lidhe këtë Kontrate dhe është i afte te përmbushë te gjitha detyrimet qe rrjedhin për Blerësin prej kësaj Kontrate; (ii) kjo Kontrate përben detyrim te ligjshëm dhe te ekzekutueshëm ndaj Blerësit dhe çdo pasuesi te tij ne përputhje me kushtet e parashikuara ne te; (iii) Blerësi është njohur me gjendjen financiare dhe statutin e Shoqërisë dhe nuk ka asnjë pretendim te tashëm dhe/ose te ardhshëm ndaj Shitësit ne lidhje me çmimin e Shitjes.


#### **TE NDRYSHME NENI 5**

5.1 Për çështjet te cilat nuk janë parashikuar ne këtë Kontrate apo qe mund te rrjedhin prej saj do te zbatohet legjislacioni përkatës ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë.

5.2 Çdo mosmarrëveshje qe mund te lind midis palëve te kësaj Kontrate ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate, nëse nuk zgjidhet ne mirëkuptim mes vete palëve, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.


5.3 Kjo Kontrate përgatitet dhe nënshkruhet ne dy kopje ne gjuhen shqipe dhe ky akt përben te gjithë marrëveshjen e arritur midis palëve, premtimet, deklaratimet, garancitë ne lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

SHITESI

  
z. Erind SULA



BLERESI

  
z. Bledar SULA

